



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 26 shkurt, 1 dhe 12 mars.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala

Mungojnë:

Të ftuar:

z. Sokol Dedja, Zëvendësministër

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, a mund të mos më ndërhyjni në drejtimin e komisionit deri ditën që parlamenti më rrëzon si kryetar i këtij komisioni?!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi miratimin e procesverbaleve të datave 26 shkurt, 1, 11, 12 mars. A keni kundërshtime lidhur me procesverbalet që përmenda? Nuk keni.

Pika e dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”. Relatore e këtij projektligji është zonja Gjylameti.

Fjala është për ju, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017” është nënshkruar në dhjetor të vitit 2018. Kjo marrëveshje ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare, që lidhin Shqipërinë me Malin e Zi, nëpërmjet projekteve të përbashkëta, shkëmbimit të përvojës dhe njohurive ndërmjet përfituesve, si dhe përmirësimit të politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale e lokale në zonën ndërkufitare. Kjo marrëveshje parashikon financimin nga granti i BE-së nëpërmjet instrumentin IPA II, në vlerën 1,19 milionë euro për të dyja vendet dhe bashkëfinancimin kombëtar prej 210 mijë eurosh nga të dyja shtetet.

Ky financim do të mbulojë alokimet e vitit 2017 dhe do të përdoret në këto fusha prioritare:

- Nxitjen e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore e natyrore;

- mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe të lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- nxitjen e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe të përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Zonat shqiptare që do të përfitojnë nga kjo marrëveshje janë Shkodra, Lezha dhe Tropoja. Marrëveshja është pjesë e programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri 2014-2020, i cili parashikon dhënien e një kontributi financiar nga BE-ja prej 11,9 milionë eurosh, si dhe një kontribut të shteteve pjesëmarrësve, për të nxitur bashkëpunimin dhe zhvillimin social - ekonomik rajonal, forcimin institucional dhe avancimin e reformave përgatitore për anëtarësim në BE. Deri tani janë ratifikuar tri marrëveshje financimi, në kuadër të këtij programi, të cilat parashikojnë financimet përkatëse për alokimet e viteve 2014, 2015 dhe 2016.

Komisioni ynë është i mendimit se kjo marrëveshje ka rëndësi të veçantë, pasi do të sigurojë mbështetje financiare për zhvillimin e disa zonave të vendit që janë në kufi me Malin e Zi. Gjithashtu, ajo do të kontribuojë në zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e punësimit në këto zona.

Për sa parashtrova më sipër, i propozoj komisionit miratimin e kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

A ka ndonjë pyetje apo koment nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë votimin në parim të këtij projektligji.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen, për pyetjet dhe komentet tuaja!

Komisionin e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti